

FORCIMI I

PJESËMARRJES

SË NXËNËSVE

| Udhërrëfyes për politika, Maqedonia e Veriut

**START THE
CHANGE!**

IMPRESUM

TITULLI

Forcimi i pjesëmarrjes së nxënësve – Udhërrëfyes për politika, Maqedonia e Veriut

BOTUES

Forumi për liri në arsimin
Xhorxhiçeva 8, 10 000 Zagreb, Kroaci

PËR BOTUESIN

Ana Munivrana

AUTORË

Biljana Trajkovska dhe Ketii Kostovska

REDAKTOR

Lana Jurko, Rrjeti i Qendrave të Politikave Arsimore NEPC

DIZAJNI GRAFIK

ACT Printlab

Zagreb, v. 2022

ЗАПОЧНИ ЈА
ПРОМЕНАТА!
START THE
CHANGE!

PROJEKTI „Fillo ndryshimin – Krijimi i gjeneratës së pararendësve të ndryshimit përmes arsimit interkulturore dhe vullnetarizmit“ (Marrëveshja nr.: 612200-EPP-1-2019-1- HR-EPPKA3-IP1-SOC-IN) Erasmus + Aksioni kyç 3: Mbështetje për reformë politike. Lloji i aksionit: Inkluzion social përmes arsimit, trajnimit dhe të rinjve. Zagreb, v. 2022

Bashkëfinancuar nga
programi Etazmus + të
Bashkimi Evropian



Ky publikim është bashkëfinancuar nga programi Erasmus + i Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

KONTEKST

Pse pjesëmarrja e nxënësve është me rëndësi në nivelin politik dhe shkollor?

Forumi për Liri në Arsim (Kroaci), së bashku me organizatat partnere INOVA+ (Portugali), QMEQ (Maqedonia e Veriut), Rrjeti i Qendrave të Politikave Arsimore NEPC, SIRIUS - Rrjeti i Politikave për Arsimin e Migrantëve, Shkolla fillore "Ivan Meshtroviq" (Kroaci) dhe Grupi i shkollave "Hose Estevas" (Portugali) dhe shkolla e mesme komunale "Nikolla Karev" (Maqedonia e Veriut), implementuan projektin "Fillo ndryshimin - Krijimi i gjeneratës së pararendësve të ndryshimit përmes arsimit interkulturor dhe vullnetarizmit" në kuadër të programit Erasmus+ (K3, Inkluzioni social).

Qëllimi i projektit është të forcojë qëndrueshmërinë e të rinjve duke i mbështetur ata në përpjekjet e tyre për të qenë persona të shëndetshëm, me vetëbesim, të përmbushur, të hapur, të cilët do të formojnë dhe mirëmbajnë lidhje (relacione) të shëndetshme, do të zhvillojnë aftësinë për t'u përfshirë në mënyrë aktive në bashkësinë e tyre pavarësisht nga prejardhja dhe rrethanat e tyre dhe pavarësisht nga sfidat potenciale me të cilat përballen. Sigurimi i kushteve për të rinjtë që të shprehin këndvështrimin e tyre për botën dhe të përjetojnë se si është të jenë të dëgjuar dhe të shikuar nga mësimmshënësit e tyre, si dhe të marrin mbështetje në iniciativat për projekte kreative dhe novatore përmes të cilave do të mund t'i shprehin (realizojnë?) talentet e tyre, vlerat dhe potenciali për rritje, do të forcojnë rezistencën e tyre dhe do të ulin rrezikun e manipulimit, pikëpamjeve ekstreme ose lidhjeve (relacioneve?) dhe qëndrimeve të dëmshme.

Qëllimi politik i projektit është të forcojë shkollat, mësimmshënësit dhe prindërit në mënyrë që ata të mbështesin dhe respektojnë zërin e nxënësve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën e shkollës dhe bashkësisë së tyre lokale në të tri vendet që zbatojnë projektin (Kroaci, Portugali dhe Maqedoninë e Veriut).

Prandaj, klasteri i parë i projektit FILLO NDRYSHIMIN hulumtoi perspektivat e vetë të rinjve për atë se si e shohin ata bashkësinë e tyre shkollore, pozicionin e tyre në të dhe nëse dëgjohej dhe shikohet apo jo. Këto njohuri ishin pika fillestare për zhvillimin e klasterit të dytë të materialeve për FILLO NDRYSHIMIN dhe planet mësimore për trajnim të mësimmshënësve dhe prindërve, në mënyrë që t'i inkurajojmë së bashku me të rinjtë për të krijuar ndryshime pozitive në shkollat dhe hapësirën për nxënie. Në klasterin e tretë, projekti FILLO NDRYSHIMIN synon të inkurajojë të rinjtë, me mbështetjen e mësimmshënësve të tyre, që të krijojnë dhe të udhëheqin iniciativa vullnetare që do të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve, të identifikuar më paraprakisht nga të rinjtë. Më pas, në klasterin e katërt, organizatat partnere në bashkëpunim me palët e ndryshme të interesuara në 3 shtete dhe në nivel të BE-së zhvillojnë rekomandime plotësuese për forcimin e zërit të nxënësve dhe për pjesëmarrjen e tyre në shkollat e tyre dhe sistemet arsimore në nivel të krijimit të politikave.

Fokusi kryesor i të gjitha klastereve të projektit është promovimi i zërit të nxënësve dhe pjesëmarrjes së tyre, për arsye se një numër gjithnjë e më i madh i hulumtuesve bëjnë të ditur se kjo e mbështetë hapjen e hapësirës dhe kapaciteteve për personat e ri e marginalizuar që të luajnë role kyçe në ndryshimet pozitive në shkollat dhe hapësirën për nxënie, mbështetë mjedise më të drejta sociale shkollore, garanton se edhe personat e rinjt të cilëve u është bërë padrejtësi do të jenë të përfshirë në proceset e vendimmarrjes, dhe kultivon zhvillimin pozitiv e të rinjve përmes veprimt të tyre dhe angazhimit qytetar.

Çfarë dimë për pjesëmarrjen e nxënësve në MK

Nevoja për pjesëmarrje aktive të nxënësve në jetën shkollore për të gjitha çështjet që u interesojnë po ashtu rezulton nga qasja e përgjithshme e Konventës për të drejtat e fëmijës e Kombeve të Bashkuara, që thekson se fëmijëria nuk është vetëm përgatitje për periudhën kur do të jemi të rritur, por po ashtu është periudhë e veçantë e jetës së çdo qenie njerëzore, në të cilën fëmijët duhet të trajtohen si individë me të drejtat e tyre personale, si të barabartë me të rriturit dhe si pjesëmarrës aktiv në zhvillimin shkollor dhe zhvillimin e bashkësisë, dhe të cilët duhet të zhvillohen në qytetarë të aftë dhe të përgjegjshëm të cilët do t'i respektojnë të drejtat e të tjerëve. Vetëm shkolla e hapur e cila mundëson pjesëmarrje demokratike të nxënësve dhe e nxitë motivimin për nxënie dhe pjesëmarrje në shkollë paraqet garanci për stabilitetin e shkollës, vendosjen e raportit të respektit mes të rriturve dhe fëmijëve dhe mjedis përkatës në të cilin fëmijët dhe të rriturit ndjehen komod.

Sipas shumë studimeve, pjesëmarrje e nxënësve e kultivon zhvillimin e kompetencave që nevojiten për rritjen e tyre në shoqëri demokratike. Përmes procesit të pjesëmarrjes, nxënësit përvetësojnë njohuri, shkathtësi dhe vlera që i përgatisin për forma më komplekse të pjesëmarrjes në jetë si persona të rritur. Nga pikëpamja e zhvillimit, pjesëmarrja siguron vazhdimësi mes jetës si fëmijëria dhe moshë madhore, meqë siguron zhvillimin e kompetencave të tilla si mendimi kritik, autonomia dhe përgjegjshmëria, që i nevojiten çdo qytetari të rritur në çdo shoqëri demokratike.

Rëndësia e procesit të konsultimit me nxënësit është e trefishtë. Së pari, konsultimi me nxënësit u ndihmon të rriturve që të largojnë veten nga qendra, respektivisht, që të kuptojnë edhe perspektivën e nxënësve. Konsultimi me nxënësit në disa shkolla për problemet me të cilat janë përballur ata e tregoi dallimin e madh mes perspektivave të mësimit dhe nxënësve. Nxënësit i konsideruan të rëndësishme disa nga problemet që mësimit nuk i shihnin fare si të rëndësishme. Së dyti, konsultimi me fëmijët po ashtu ndihmon edhe të rriturit që të përvetësojnë pasqyrë më të mirë për problemet me të cilat përballen fëmijët. Kur bëhet fjalë për interesin më të mirë të fëmijës, konsultimi me nxënësit rrit gjasat e marrjes së vendimeve që janë në interesin e tyre më të mirë (Pjesëmarrje e nxënësve: Politika dhe praktika e "Fillo ndryshimin", Forumi për Lirinë në Arsim, 2020). Së fundi, fokusimi në inkluzionin social të të rinjve, ndihma që ata të zhvillojnë vetëbesimin, ndjenja për identitet dhe përkatësi dhe të nxënësve se si të mendojnë në mënyrë kritike janë ndër elementët më të rëndësishëm për parandalimin e suksesshëm të radikalizimit të të rinjve. Vlerësimi dhe sigurimi i mundësive për pjesëmarrje dhe për dëgjimin e zërit të të rinjve janë elemente kyçe për forcimin e ndjenjës së përkatësisë së nxënësve dhe zhvillimin e vetëbesimit të tyre, veçanërisht për ata që janë në situata të rrezikuara.

Ka shembuj të pjesëmarrjes së nxënësve në procesin e vendimmarrjes në Maqedoninë e Veriut edhe deri tani, por vetëm në dy vitet e fundit koncepti i përfshirjes aktive të nxënësve në planifikimin shkollor ka fituar një bazë më të fortë. Ligji për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 161/19 dhe 229/20), për herë të pari i rregullon organizatat e nxënësve dhe pjesëmarrjen në bashkësitë shkollore (Neni 68). Në mënyrë që të sigurohet realizim i interesave të nxënësve në mënyrë të organizuar në shkollat fillore, nxënësit do të organizohen në mënyrë të mëvetësishme në nivel të klasës dhe në parlamentin e nxënësve. Sipas përkufizimit në Ligj, parlamenti i nxënësve merr pjesë aktive në përfaqësimin dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve, promovon aktivizmin e nxënësve, merr pjesë në aktivitete për sigurimin e mbështetjes nga moshatarët për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe në realizimin e orëve dhe aktiviteteve jashtëshkollore, merr pjesë në përvijimin e programit vjetor të punës në shkollë, jep propozime për programet vjetore për ekskursione, jep propozime për aktivitete jashtëshkollore në shkollë, jep propozime për përmirësimin e standardit të nxënësve, merr pjesë në vlerësimin e shkollës, merr pjesë në këshillin e prindërve dhe këshillat e mësimit dhe me përfaqësuesit e tyre dhe organizon dhe merr pjesë në aktivitete humanitare, aktivitete ekologjike dhe punë që është e dobishme për bashkësinë. Ligji, po ashtu, rregullon rolin e avokatit të nxënësve, i cili është të garantojë mbrojtjen dhe të promovojë të drejtat e nxënësve në shkollë. Në bazë të kësaj, nga Byroja e Zhvillimit të Arsimin në vitin 2020 është përgatitur Udhëzues për pjesëmarrjen e nxënësve, organizimin e nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore. Për momentin është duke u përgatitur edhe një ligj i ngjashëm për arsim të mesëm, që pritet të miratohet deri në fund të vitit 2022.

Hulumtimet e fundit të zbatuara nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar tregojnë se në shkollat fillore është vendosur trup përfaqësues i nxënësve "Parlamenti i nxënësve" (PN), i përbërë nga kryetarët e klasave nga secila klasë. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin se vendosja e dispozitave për organizimin e nxënësve është relativisht e re në Ligjin për arsimin fillor, detyrimi ligjor për të vendosur PN filloi të jetë i detyrueshëm shumë pak kohë më parë. Shkollat kanë bërë përparim të mirë kur bëhet fjalë për aspektet teknike dhe procedurale të procesit të pjesëmarrjes së nxënësve, por megjithatë, cilësia e përgjithshme e pjesëmarrjes dhe ndikimi janë relativisht ulët. Në shumicën e shkollave të mesme, bashkësia e klasave/bashkësia e nxënësve janë format më të shpeshta përmes të cilave nxënësit i përfaqësojnë qëndrimet dhe mendimet e tyre dhe në të shumtën e rasteve janë të informuar për politikën arsimore dhe planet e organeve të shkollës në të cilën e ndjekin mësimin. Format e pjesëmarrjes dhe organizimit për nxënësit e shkollave të mesme ndryshojnë, në varësi të vullnetit të çdo shkolle, edhe pse ka iniciativë dhe ndërgjegjësim të pranuar mes nxënësve të shkollave të mesme për nevojën për t'u bashkuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrjet.

Hulumtimi i QMEQ-së për pjesëmarrjen demokratike në shkollat fillore dhe të mesme (v. 2018) tregon se nxënësit ndihen më të hapur për t'i treguar problemet që i prekin gjatë orës së tyre në klasë ose në mbledhjet e bashkësive të shkollave. Megjithatë, kur një çështje/problem i veçantë duhet të transferohet në nivel më të lartë, ata ndjejnë se nuk kanë njohuri të mjaftueshme, shkathtësi dhe procedura formale për të vepruar. Në raport me mundësitë që nxënësit i kanë për të marrë pjesë dhe për të ndikuar në miratimin e vendimeve për aspektet që u interesojnë dhe ndikojnë tek ata, rreth gjysma e nxënësve të anketuar janë shprehur se kanë pasur mundësinë për të marrë pjesë shpesh ose ndonjëherë, derisa të tjerë kanë pohuar se mundësi të tillë nuk kanë pasur asnjëherë, ose rrallë. Në përgjithësi, nxënësit dyshojnë në bindjen se ata mund të iniciojnë ndryshime pozitive në bashkësinë. Çdo i dyti nxënës konsideronte se nxënësit mund të ndikojnë në iniciimin e ndryshimit të caktuar në shkollë. Një fakt që inkurajon është se shumica e nxënësve janë ndier se kanë përgjegjësi të jenë aktivë në përballjen me nevojat e mjedisit të tyre, dhe se e kanë fuqinë për të arritur dallim në shkollë. Megjithatë, ajo që shqetëson është fakti se thuhet gjysma e tyre konsideronin se nëse haptazi dhe zëshëm i shprehin mendimet e tyre, do të mund të kishin probleme në shkollë.

Projekti për Integrimin Ndëretnik e të Rinjve (i implementuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar dhe Forumi Rinor Arsimor), përmes Byrosë së Zhvillimit të Arsimit punon me mësimdhënësit e Arsimit qytetar dhe personelit për mbështetje në shkollat për t'i mbështetur nxënësit që t'i shprehin nevojat dhe shqetësimet e tyre dhe të arrijnë ndryshime pozitive në bashkësinë përmes zbatimit të iniciativave të nxënësve. Nga të gjitha shkollat fillore pritet të realizojnë procesin e sendërtimit të kapaciteteve dhe mbështetjen e mentorimit deri nga mesi i vitit 2022. Projekti gjithashtu punon për të ndërlidhur nxënësit me komunat dhe organizimin e aksioneve në bashkësitë të kryesuara nga të rinjtë për të përmirësuar disa aspekte të jetës së përbashkët, të zgjedhura nga nxënësit dhe të implementuara në bashkëpunim me komunën.

Sipas Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nr. 10/2020), çdo komunë duhet të formojnë/vendosë: a) këshill lokal rinor, b) parlament lokal rinor, dhe c) qendër rinore. Është me rëndësi të përmendet se ligji i përcakton të rinjtë si shtetas të Maqedonisë së Veriut të moshës nga 15 deri 29 vjeç, kështu që sipas kësaj është relevant për nxënësit e arsimit të mesëm, dhe për më të moshuarit. Për këshillat lokale rinore pritej të vendosen në afat prej një viti pas miratimit të Ligjit në janar të vitit 2020, derisa nga të gjitha këshillat tashmë ekzistuese lokale rinore me mandat të papërfunduar pritej të transformohen sipas kushteve të reja të Ligjit. Agjencia e Rinisë dhe Sporteve dhe këshilltari i kryeministrit për politika rinore, me mbështetjen e misionit lokal të OSBE-së, zbatuan sesione informative me komunat për kushtet e parashikuara në Ligjin e ri. Rreth dy të tretat e komunave u informuan për rolin e tyre në procesin e vendosjes së këshillave lokale rinore, ndërsa një pakicë e vogël e kanë filluar tashmë procedurën.

Pse nxënësit duhet të marrin pjesë në zhvillimin e programeve mësimore

Programi mësimor është krijuar me nxënësit si fokusin e tij qendror. Megjithatë, zëri i nxënësit në të shumtën e rasteve është në masë të madhe i përjashtuar nga procesi i krijimit dhe implementimit të programit mësimor. Vetëdija për problemet që lidhen me vëmendjen e pamjaftueshme që i kushtohet zërit të nxënësve është vërejtur edhe nga disa teoricienë paraprak të programeve mësimore, por megjithatë, madje para do kohë koncepti i pjesëmarrjes së nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore filloi të zbatohet në mënyrë aktive në fushën e programit mësimor.

Studimi tregon se konsultimi me fëmijët dhe respektimi i perspektivave të tyre çon në ndryshime të mëdha në aspektet e ndryshme të arsimit, të tilla si ndryshimi i raportit mes programeve shkollore dhe aktiviteteve jashtëshkollore dhe pjesëmarrjes më të madhe të fëmijëve në përzgjedhjen e programeve mësimore (përzgjedhje e përmbajtjeve/ temave, dhe metodave të nxënies), si dhe aktivitetet jashtëshkollore (Flater dhe Radak, v. 2004). Një studim tjetër tregon se “zëri” i nxënësve u jep nxënësve ndjenjën e kuptimit dhe ndërlihdjes me programin mësimor (AKU, v. 2008)

Një temë e zakonshme që rezultoi nga shqyrtimi historik ishte ndjenja se angazhimi personal i nxënësve rritet kur dëgjohej edhe zëri i tyre. Megjithatë, për shkak të fuqisë së argumentit në favor të zërit të nxënësve në teorinë e programit mësimor, është e rëndësishme të shkojmë një hap më tej dhe të kërkojmë lidhjen mes angazhimit dhe suksesit akademik. Edhe pse hulumtimet në këtë fushë janë relativisht të reja, janë vërejtur lidhje pozitive mes angazhimit dhe nxënies. Një analizë e gjerë në nivel të universitetit zbuloi se “angazhimi i nxënësve është i lidhur pozitivisht me epilogët e dëshirueshëm nga nxënia, të tilla si të menduarit kritik dhe notat e mira” (Karini, Kuh dhe Klajn, v. 2006, f. 23).

Prandaj, ne besojmë se përfshirja e nxënësve në procesin e planifikimit të programit mësimor është mënyrë për përmirësimin e nxënies nga nxënësit.

Pse nxënësit duhet të marrin pjesë në strukturën administrative dhe organet e shkollës

Nxënësit të cilët janë të përfshirë në jetën shkollore ndjehen si pjesë qendrore dhe esenciale e saj, ndjejnë se shkolla kujdeset për ta, dhe se mund t’i kundërpërgjigjen me pjesëmarrjen e tyre aktive, që më tutje shpie drejt zhvillimit të vazhdueshëm të shkollës. Në fund, atmosfera që krijohet në kushte të tilla kontribuon drejt përmirësimit të marrëdhënieve ndërnrjore mes fëmijëve dhe të rriturve.

Hulumtimet tregojnë se për nxënësit ekzistojnë përfitime të ndryshme nga pjesëmarrja aktive e nxënësve, siç janë: vetëbesimi i rritur, ndjenja e rritur e përgjegjësisë, kompetencat e rritura komunikuese dhe organizative, ndjenja e rritur e lumturisë dhe përkatësisë ndaj shkollës, bindja e forcuar se nxënësit mund të fillojnë ndryshimin.

Prandaj, nxënësit duhet të jenë të përfshirë në mënyra të ndryshme dhe në nivele të ndryshme nga miratimi i vendimeve ndaj të gjitha çështjeve që ndikojnë në shkollën. Nxënësit mund të marrin pjesë në thuajse të gjithë domenët e jetës shkollore, që janë të lidhur me: mësimin, aktivitetet jashtëshkollore, marrëdhëniet mes nxënësve, marrëdhëniet me të rriturit dhe kushtet fizike në shkollë, etj. Pjesëmarrja në Parlamentin e nxënësve dhe organet tjera të Drejtorisë së shkollës mund ta përmbajë edhe rolin e përfaqësimit të të drejtave të nxënësve dhe të jetë katalizator për ndryshime të caktuara.

PROCES (METODOLOGJI)

Si arritëm deri te Udhërrëfyeni për politika?

Procesi filloi me mbledhjen e materialeve dhe të dhënave themelore për pjesëmarrjen e nxënësve në tri vendet që e zbatojnë projektin që shpijnë drejt përpilimit të raportit për hulumtim të analizës së punës “Pjesëmarrje e nxënësve: politikat dhe praktikat për fillimin e ndryshimit” dhe raportit komparativ “Zëri i nxënësit si shenjë e shkollës cilësore” me vëzhgime nga nxënësit e shkollave të zgjedhura në Portugali, Maqedoninë e Veriut dhe Kroaci për pjesëmarrje aktive, marrëdhëniet dhe orët gjatë krizës COVID-19.

Në mënyrë që të përgatitet në mënyrë përkatëse Laboratori i parë për politika, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar mbledhi të dhëna nga shkollat që morën pjesë në projektin dhe bëri draft të raportit për praktikën e pjesëmarrjes së nxënësve në Maqedoninë e Veriut në nivele të ndryshme.

Në maj të vitit 2021, Laboratoria e parë e politikave ishte organizuar me slloganin: “Politikat dhe praktika për të filluar ndryshimin”, si ngjarje onlajn që tuboi mbi 60 pjesëmarrës, kreatorë të politikave, mësues, liderë të shkollave dhe personel për mbështetje, si dhe përfaqësues të OJQO-ve nga vendet që e implementojnë projektin dhe rajonin e NEPC-së së bashku me Konzorciumin. Synimi kryesor i ngjarjes ishte që të vendoset dhe ngrihet vetëdija për temën e pjesëmarrjes së nxënësve dhe për rëndësinë e zërit të nxënësve lidhur me ndryshimin e politikave.

Gjatë implementimit të projektit, shkollat që morën pjesë në projektin organizuan disa aktivitete të iniciuara nga nxënësit. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte që nxënësit të bëhen të vetëdijshëm se zërat e tyre mund të dëgjohen dhe se përmes pjesëmarrjes së tyre aktive ata mund të bëjnë dallimin edhe për vetveten edhe për të tjerët.

Ashtu siç përparonte projekti, forcohej edhe vetëdija për pjesëmarrjen e rëndësishme të nxënësve. Laboratori i dytë i politikave: “Pjesëmarrja e nxënësve - rruga drejt shoqërisë inkluzive demokratike” është mbajtur në mars të vitit 2022 në Zagreb, Kroaci. Laboratori i dytë politik është ndërlidhur me njohurinë e përvetësuar dhe përvojat e ndara nga laboratorit i parë për politika dhe ishte mundësi për mësuesit e 15 shkollave në Kroaci, Maqedoni të Veriut dhe Portugali dhe vendimmarrësit për politikën në fushën e arsimit të takohen drejtpërdrejt dhe të shkëmbejnë përvojat e tyre me këtë projekt, si dhe t'i diskutojnë në mënyrë plotësuese rekomandimet për forcimin e zërit të nxënësve dhe pjesëmarrjen në shkollat e tyre dhe në sistemet arsimore.

Ngjarja shërbeu si frymëzim për diskutimet mes pjesëmarrësve në sesionin për gjenerimin e zgjidhjeve që janë të fokusuar në identifikimin e qëllimeve politike që do të ndihmojnë në tejkalimin e pjesëmarrjes së pamjaftueshme nga nxënësit në proceset e vendimmarrjes në jetën shkollore dhe menaxhimin e të gjitha niveleve me fokus special mbi potencialin që pjesëmarrja e nxënësve ta përmirësojë inkluzionin dhe t'u kundërshtohet efekteve negative të mosinteresimit të nxënësve.

Informacionet e mbledhura po ashtu shërbyen edhe për përgatitjen e këtij Udhërrëfyeni kombëtar për politika që i përmend problemet politike dhe aspektet karakteristike për këtë shtet në nivel të shkollës, në nivel lokal dhe kombëtar, dhe po ashtu ofron rekomandime për atë se si politikën të përmirësohen hap pas hapi.

Qëllimi i përgjithshëm politik

Të forcohet pjesëmarrja e nxënësve në arsim

Qëllime konkrete/specifike

1. Të sigurohet pjesëmarrje e nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore
2. Të mundësohet vendosja e modelit participues të udhëheqjes së shkollave

Rekomandime

Qëllimi konkret 1: Të sigurohet pjesëmarrje e nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore

Të sigurohet pjesëmarrje e nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore

Aktet e tanishme nënligjore të miratuara nga BZHA/Qendra për APT e rregullojnë vetëm angazhimin e mësimit dhe profesorëve universitarë si ekspertë të jashtëm për BZHA/Qendrën për APT për zhvillimin e programeve të reja mësimore dhe/ose revizion të atyre ekzistuese.

Ngritje të vetëdijes mes palëve të interesuara për rëndësinë e përfshirjes së nxënësve në zhvillimin e programit mësimor

Për shkak të faktit se në Maqedoninë e Veriut asnjëherë më parë nuk ekzistonte praktika që të përfshihet edhe zëri i nxënësve gjatë zhvillimit të programit mësimor, është e nevojshme që të rritet niveli i vetëdijes mes palëve të prekura. Megjithatë, prej para do kohë kishte shembuj pozitivë të inkluzionit të nxënësve në procesin e marrjes së vendimeve, si zhvillimi i konceptit të ri për arsimin fillor në vitin 2021 dhe zhvillimin e modelit të ri për Provimin e maturës për vitin akademik 2020/2021.

Trajnim i nxënësve

Shembuj të konsultimeve me fëmijët në shkollat fillore dhe të mesme tregojnë se shumica e nxënësve (pavarësisht nga mosha) janë kompetentë në mënyrë ekstreme në diskutimin e programit mësimor dhe proceset e nxënies, edhe pse (veçanërisht nxënësit më të rinj) nuk kanë gjithmonë mundësinë për të artikuluar perspektivën e vet me përdorimin e gjuhës së arsimit formal (Fillater dhe Radak, v. 2004).

Qëllimi konkret 2: Të mundësohet vendosja e modelit participues të udhëheqjes së shkollave

Ngritja e nivelit të vetëdijes në mesin e personelit në shkollat për rëndësinë e pjesëmarrjes së nxënësve

Ndonëse mësimit dhe nxënësve luajnë rol të rëndësishëm në procesin, edukatorët kanë qëndrime të ndryshme rreth asaj se çfarë nënkupton pjesëmarrja e nxënësve. Edukatorët e përfshirë në dizajnin e modelit participues mund të ndahen në tre grupe: grupi i konsulentëve proaktivë, konsulentë menaxhues dhe grupi i konsultimit të kufizuar (Tomson, v. 2009)

Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional (KPD) të edukatorëve për pjesëmarrje të nxënësve dhe modeli participues i udhëheqjes së shkollave

Sistemi momental arsimor nuk është i dizajnuar në mënyrë që mësimit të nxënësve që janë në fillim të profesionit, e të cilëve u sigurohet të kuptuarit e nevojshëm filozofik dhe shkathtësitë e trajnimit në mënyrë që të krijohen mundësi për partneritet mësimit të nxënësve. Prandaj, është me rëndësi që të vlerësohen përpjekjet e mësimit të nxënësve dhe të drejtorëve të shkollave, respektivisht mësimit dhe drejtorët të cilët e nxisin dhe mbështesin pjesëmarrjen e nxënësve në udhëheqjen e shkollës t'i marrin parasysh edhe përpjekjet e këtyre në metodologjinë për përparim profesional (në karrierë).

Sigurimi i programeve për personelin shkollor dhe nxënësit për komisionet e nxënësve në mënyrë që të përmirësojnë të kuptuarit e tyre të karakteristikave dhe funksioneve të këtyre trupave/organeve

I gjithë koncepti i pjesëmarrjes së nxënësve (duke përfshirë edhe komisionet dhe këshillat e shkollave) duhet të jetë i përkufizuar qartë, ndërsa pritjet edhe për nxënësit edhe për mësimit duhet t'i kuptojnë të gjithë të përfshirët në procesin e ndryshimit.

Mundësimi i pjesëmarrjes së nxënësve dhe sigurimin i zhvillimit të tij nga formaliteti i thjeshtë në proces të rëndësishëm, respektivisht krijim të mjedisit inkurajues

Kur zëri i nxënësve do të vendosej në mënyrë artificiale, kjo në fakt mund të jetë e dëmshme për mjedisin shkollor. Kjo është veçanërisht e saktë nëse ekziston histori e trajtimit të nxënësve pa respekt ndaj nxënësve. Qasjet e pasinqerta ndaj partneritetit mësimit të nxënësve do të sjellin deri te ajo që nxënësit të bëhen të painteresuar dhe të tjetërsuar (Mitra dhe Gros, v. 2009).

Forcimi i pjesëmarrjes së nxënësve në shkollë

Qëllimet konkrete	Rekomandime	Aksion	Udhëheqës/Aktorë	Niveli i implementimit	Korniza kohore/prioritete
1. Sigurimi i pjesëmarrjes së nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore	Miratimi i akteve nënligjore për përfshirjen e nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore	<ol style="list-style-type: none"> Krijimi i grupeve të punës (RG) për ndryshimin e akteve nënligjore <ol style="list-style-type: none"> Përkufizimi i fushës së GP (Duhet të vlerësohet) Përkufizimi i anëtarëve të GP-së Formimi i GP-së Hartimi i akteve të reja nënligjore <ol style="list-style-type: none"> Analiza e praktikave të mira Anketa/Grupe fokusi me mesimdhënës/nxënës/kategori të rrezikuara Drafti i konceptit të pjesëmarrjes së nxënësve, i cili duhet të përkufizohet qartë Përgatitja e draft-akteve nënligjore Miratimi i akteve nënligjore <ol style="list-style-type: none"> Konsultime publike Përfshirje të komenteve Miratimi i akteve nënligjore 	Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Byroja për Zhvillimin e Arsimit/Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim	Niveli politik	Korniza kohore/prioritete
1. Sigurimi i pjesëmarrjes së nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore	Ngritja e nivelit të vetëdijes mes palëve të interesuara për rëndësinë e përfshirjes së nxënësve në zhvillimin e programeve mësimore	<ol style="list-style-type: none"> Angazhimi i ekspertëve me përvojë paraprake në përfshirjen e nxënësve gjatë zhvillimit të programeve mësimore në mënyrë që të promovohen përfitimet (p.sh. përmirësimi i nxënies së nxënësve). Duhet të sigurohen të dhëna konkrete që mund të vërtetojnë pohimin se dhënia e një rëndësie më të madhe për zërin e nxënësve do të ketë efekt të prekshëm pozitiv në angazhimin e nxënësve dhe arritjeve të tyre. Tryeza të rumbullakëta me përfaqësues nga MASH-i, BZHA-ja, Qendra për APT, nga universitetet, mesimdhënësit dhe nxënësit për t'i prezantuar rezultatet e analizës së praktikave të mira dhe për të diskutuar mënyrat e përfshirjes së nxënësve në zhvillimin e programit mësimor. Pritjet nga nxënësit duhet të kuptohen nga të gjithë të përfshirët në procesin. 	MASH/BZHA/QAPT		
	Trajnim i nxënësve	<ol style="list-style-type: none"> Krijimi i modulit për trajnim për pjesëmarrjen e nxënësve nga këshilltarët në BZHA dhe Qendrën për APT. Trajnim i nxënësve të interesuar për të marrë pjesë dhe për të shprehur perspektivën e tyre në zhvillimin e programeve mësimore 	MASH/BZHA/QAPT		
	Ngritja e nivelit të vetëdijes së stafit të shkollës për rëndësinë e pjesëmarrjes së nxënësve	<ol style="list-style-type: none"> Përkufizimi i kornizës së qartë për pjesëmarrjen e fëmijëve në udhëheqjen e shkollës Organizimi i seminareve për drejtorë dhe personel të shkollës për rëndësinë e pjesëmarrjes së nxënësve 	MASH/BZHA/QAPT/Shkollat/Autoritetet lokale	Niveli shkollor	Menjëherë Në mënyrë të vazhdueshme

	<p>3. Promovim i praktikave të mira në nivel shkollor dhe komunal në bashkëpunim me mediat</p> <p>4. Diskutim i mundësive dhe përparësive të pjesëmarrjes së nxënësve në këshillin e mësimdhënësve dhe mbledhjet për aktivtete</p>
<p>Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të edukatorëve për pjesëmarrjen e nxënësve dhe modelit participues të udhëheqjes së shkollës</p>	<p>1. Ndryshime në dy aktet nënligjore për trajnimin e drejtorëve (themelor dhe të avancuar) dhe certifikim (Gazeta Zyrtare Nr. 219/15) në mënyrë që të shtohet modul për trajnime për pjesëmarrjen e nxënësve.</p> <p>2. Akreditimi i organizatorëve të trajnimit dhe programeve të trajnimit të mësimdhënësve për pjesëmarrjen e nxënësve, nga BZHA-ja dhe shtimi i këtyre programeve në katalogun zyrtar të trajnimit dhe në programin e trajnimit të mësimdhënësve të maturuar në nivel vjetor nga MASH-i.</p> <p>3. Ndryshime në aktin nënligjor për zhvillim në karrierë (Rregullorja për standardet profesionale për titullin mësimdhënës-mentor dhe mësimdhënës-këshilltar, dhe mënyra e marrjes së këtij titulli) me qëllim që të vlerësohen/merren parasysh për-pjekjet/aktivitetet e mësimdhënësit për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për pjesëmarrjen e nxënësve</p>
<p>Sigurimi i programeve për personelin e shkollës dhe për nxënësit për komisionet e shkollës për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për karakteristikat dhe funksionet e atyre organeve</p>	<p>1. Krijimi i udhëzimeve për pjesëmarrjen e nxënësve në shkollat e mesme (duke u bazuar në udhëzimet e zhvilluara tashmë për shkollat fillore)</p> <p>2. PËRGATITJA e doracakut me shembuj të praktikave dhe projekteve/aktiviteteve të mira që mund të organizohen nga Parlamenti i shkollës dhe avokati i nxënësve (p.sh. si të merret pjesë në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin e programit vjetor të punës së shkollës; si të merret parasysh zëri i nxënësve të marginalizuar, si të përmirësohen standardet e nxënësve, aksionet e bashkësisë, si të ndërtohen marrëdhënie më të forta mësimdhënës-nxënës, etj.)</p> <p>3. Organizimi i sesioneve për trajnim për anëtarët e Parlamentit të nxënësve</p>
<p>Mundësimi i pjesëmarrjes së nxënësve dhe sigurimi i zhvillimit të tyre nga vetë formaliteti në proces të rëndësishëm (krijimin e mjedisit inkurajues)</p>	<p>1. Organizimi i projekteve shkollore me rritje graduale të nivelit të përgjegjësive që e kanë nxënësit në implementimin e detyrës dhe përfshirjen aktive të më shumë nxënësve.</p> <p>2. Prezantimi i mënyrave kreative të anketimit të mendimit dhe analizës së nevojave të të gjithë nxënësve, për temat që do të dalin përpara prezantimit në Këshill.</p> <p>3. Organizimi i tubimeve mësimdhënës-nxënës gjatë vitit shkollor në mënyrë që ata të njihen me njëri-tjetrin, duke përmirësuar në këtë mënyrë komunikimin e tyre të ndërsjellë.</p>

3. Mundësimi i vendosjes së modelit participues të udhëheqjes së shkollës

LITERATURA

AKU (2008). Fusha e studimit për qasjet ndaj mirëqenies së nxënësve: Pasqyrë e literaturës. Universiteti Kato-lik Australian (ACU) dhe &Erebus Internacional (Scoping study into approaches to student wellbeing: Literature review)

Karini, R. M., Kuh, G. D., iKlajn, S. P. (v. 2006). Angazhimi i nxënësve dhe nxënia e nxënësve: Testimi i lidhshmërisë. Huluntim në arsimin më të lartë, 47(1), 1-33. DOI:10.1007/s11162-1850-9(Student engagement and student learning: Testing the linkages. Research in higher education)

Flater, Xh. & Radak, Xh. (v. 2004).Konsultime me nxënësit: Çfarë i pret shkollat? Londër dhe Nju-Jork: Rutlexh Falmer (Consulting pupils: What's in it for schools?)

J. Vranjesheviq, M. Dermish (v. 2020) Pjesëmarrje e nxënësve: Politika dhe praktika për fillimin e ndryshimit, Ra-
port nga desk-huluntimi, Forum për liri në arsimin. Zagreb, Kroaci (Students' participation: Policy and Practice to
Start the Change, Desk Research Report)

J. Jagersma (v. 2010), Forcimi i nxënësve si pjesëmarrës aktiv në dizajnin dhe implementimin e programit mësi-
mor, Huluntim të sistemit arsimor të Albertës.(Empowering Students as Active Participants in Curriculum De-
sign and Implementation, Research into the Alberta Education System.)

Ligji për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 161/19 dhe 229/20)

Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 10/2020)

M. Çeshllarov etj.. (v.2020.), Udhëzues për pjesëmarrje të nxënësve, organizim i nxënësve dhe mbrojtje të të
drejtave të fëmijëve në shkollat fillore, Koalicion i organizatave rinore SEGA, Prile, Republika e Maqedonisë së
Veriut, ISBN 978-608-4631-12-5, COBISS.MK-ID 11197738

Mitra, D.LI., dhe Gros, S.Xh. (v.2009). Ngritje të zërit të nxënësve në reformën e arsimit të mesëm: Ndërtim i part-
neriteteve, përmirësim i rezultateve. Menaxhment arsimor, administratë dhe udhëheqje), 37 (4), 522-543. botimi
:10.1177/1741143209334577(Increasing student voice in high school reform: Building partnerships, improving out-
comes. Educational Management Administration & Leadership)

N. Baketa, M. Kovaçiq (2021) Raport komparativ: „Zëri i nxënësve si dorëzani për shkollë cilësore: të menduarit e
nxënësve nga shkolla të zgjedhura nga Portugalia, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia për bashkëpunim aktiv, mar-
rëdhëniet dhe mësimi gjatë krizës me KOVID-19, Forum për liri të arsimit.Zagreb, Kroaci (Comparative Report
, “Student Voice as a Token of a Quality School”, – observations by students from selected schools in Portugal,
North Macedonia and Croatia on active participation, relationships and classes during the COVID-19 crisis)

Programi për trajnim dhe provim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme (Gazeta Zyrtare e Republikës së
Maqedonisë nr. 219/15)

Programi për trajnim të avancuar të drejtorëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonis, nr. 219/15)

Huluntim i praktikave të pjesëmarrjes së nxënësve në Maqedoninë e Veriut në nivele të ndryshme (v. 2020), Qen-
dra Maqedonase për Edukim Qytetar, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Rregullore për mënyrën, procedurën dhe kriteret për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimin
e lartësisë së kompensive (2021, nr.01-195/1), Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Republika e Maqedonisë së Veriut

Rregullore për kompetencat themelore profesionale për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme në
fushat (v. 2020, Nr.18-3999/1), Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Republika e Maqedonisë së Veriut

Tompson, P. (2009). Konsultime me nxënësit e arsimit të mesëm për nxënien e tyre. Revista e Oksfordit për arsim,
35 (6), 671-687. botimi : 10.1080/03054980903357319(Consulting secondary school pupils about their learning)

Konventa e të drejtave të fëmijës e Kombeve të Bashkuara



**START THE
CHANGE!**

www.startthechange.net